



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 7675 Prot.

Tiranë, më 28.07 2016

UDHËZIM

Nr. 14, datë 28.07 2016

**PËR
VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, pika 2, germa a, dhe nenit 48 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

Neni 1

Qëllimi i vlerësimit të nxënësit

Qëllimi kryesor i vlerësimit është gjykimi mbi arritjet e nxënësit referuar filozofisë dhe përmbajtjes së kurrikulës bazuar në kompetenca si dhe të mbështesë të nxënësit dhe përparimin e nxënësit. Ky qëllim përmbushet nga kombinimi i vlerësimit për të nxënës dhe i vlerësimit të të nxënësit, bazuar në Kornizën e Vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar miratuar më datë 23.07.2015 nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Neni 2

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- 2.1. Vlerësimit të vazhduar (sipas shënimeve në evidencat e mësuesit),
- 2.2. Vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse,
- 2.3. Vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 2232455

Web site: www.arsimi.gov.al

Neni 3

Vlerësimi i vazhduar

- 1) Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- 2) Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- 3) Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënës, mësuesi mban shënime në evidencë për çdo nxënësi. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, simbole, komente etj., referuar niveleve të arritjes. Këto shënime përdoren nga mësuesi për të argumentuar vlerësimet e kryera përgjatë tremujorit. Në lidhje me këto vlerësime, mësuesi duhet:
 - Të konsiderojë dhe të paraqesë rezultatet e të nxënës për të cilat nxënësit janë duke punuar;
 - Të japë shembuj që ilustrojnë rezultatet e pritshme;
 - Të përcaktojë kriteret e suksesit përmes diskutimeve ndërmjet tyre dhe me nxënësit;
 - Të krijojë mundësi që nxënësit të demonstrojnë njohuritë, të kuptuarin, aftësitë dhe qëndrimet e tyre.
- 4) Mësuesi duhet të marrë në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënës në programin lëndor.
- 5) Mësuesi mund të përshtasë formatin e evidencës (shtojca 1), në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.

Neni 4

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësi, në përfundim të tremujorit. Ky vlerësim e orienton mësuesin për të përmirësuar mësimdhënien dhe procesin e të nxënës.

Neni 5

Vlerësimi me portofol lëndor

- 1) Vlerësimi i nxënësit bazuar në portofol lëndor, bëhet në përfundim të çdo tremujori dhe ka për qëllim vlerësimin e nxënësit në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjyimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.

- 2) Rubrikat e portofolit të nxënësit përcaktohen nga mësuesi referuar specifikave të lëndës. Rubrikat e portofolit mund të grupojnë:
- punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj,
 - projekte individuale ose në grup,
 - detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.),
 - vetëvlerësimet e nxënësit për arritjet e tij,
 - reflektime të prindit/ nxënësve të tjerë ndaj ecures dhe arritjeve të nxënësit.

Neni 6

Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve

Vlerësimi i të nxënësve të nxënësve kryhet nëpërmjet:

- Vlerësimi periodik;
- Vlerësimi përfundimtar.

Neni 7

Vlerësimi periodik

- 1) Vlerësimi periodik, kryhet në fund të një periudhe tremujore, për të evidentuar përparimin dhe arritjet e nxënësve me qëllim monitorimin dhe raportimin e tyre.
- 2) Vlerësimi periodik tremujor jepet nëpërmjet 3(tre) notave të veçanta për:
 - *Vlerësimin e vazhdueshëm me notë*, që bazohet në shënimet e mësuesit të mbajtura në evidencat për periudhën tremujore duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - *Vlerësimin me notë nëpërmjet testit ose detyrës përmbledhëse* në përfundim të periudhës tremujore.
 - *Vlerësimin me notë të portofolit të nxënësve*, për periudhën tremujore.
- 3) Këto tre vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Neni 8

Vlerësimi përfundimtar

- 1) Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor me notë dhe përshkrim referuar niveleve të arritjes.
- 2) Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* për tri periudha tremujore;
 - *Notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse* për tri periudha tremujore;
 - *Notën vjetore të vlerësimit të portofolit të nxënësve* për tri periudha tremujore.

3) Peshat në përqindje sipas vlerësimeve:

	<i>Pesha në përqindje</i>
<i>Vlerësimi i vazhdueshëm</i>	40%
<i>Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse</i>	40%
<i>Vlerësimi i portofolit të nxënësit</i>	20%

4) Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NV_V), bazuar në tre notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progressive;
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT_P) bazuar në tre notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progressive;
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_P) bazuar në tre notat tremujore, duke gjykuar në mënyrë progressive;
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse;
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (psh. 8,8 \approx 9);
- Formula: Nota përfundimtare = $(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2)$.

5) Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës.

Neni 9

Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve

- 1) Raportimi i arritjeve të të nxënësve bëhet nga mësuesi një herë në tre muaj dhe i jepet me shkrim prindit.
- 2) Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve ka dy qëllime kryesore:
 - Së pari, siguron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm rreth të nxënësve dhe përparimit të tyre, duke shërbyer si bazë për të krahasuar arritjet me rezultatet e pritshme të të nxënësve.
 - Së dyti, krijon një platformë, e cila u shërben mësuesve dhe prindërve të mbështesin nxënësit në hapat e mëtejshëm të të nxënësve, si dhe vetë nxënësve të zhvillohen në këtë proces.
- 3) Raportimi i arritjeve dhe përparimit të nxënësve bazohet në evidencat e vlerësimit të vazhdueshëm, testet/detyrat përmbledhëse si dhe portofolin e nxënësit.

Neni 10

Dispozita të fundit

- 1) Evidencat e vlerësimit të vazhdueshëm dorëzohen në përfundim të tremujorit në drejtorinë e shkollës, ku ruhen deri në përfundim të vitit shkollor.
- 2) Testet/detyrat përmbledhëse dhe portofoli i nxënësit janë objekt monitorimi deri në fund të vitit shkollor.
- 3) Ky udhëzim fillon zbatimin me klasën e 10-të të arsimit të mesëm të lartë, viti shkollor 2016-2017.
- 4) Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Agjencia Kombëtare e Provimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, DAR/ZA-të dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



EVIDENCA TREMUJORE PËR MBAJTJEN E VLERËSIMEVE TË NXËNËSVE

SHTOJCA 1

KLASA X

TREMUJORI

Komente																																																																																																				
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100
Emri mbiemri	Muajt/Datat:																																																																																																			
1																																																																																																				
2																																																																																																				
3																																																																																																				
4																																																																																																				
5																																																																																																				

Shënim: Ky format llogaritet në A3, për shkak se numri i nxënësve është më i madh. Një lëndë mund të ketë një ose dy fletë (nga të dyja faqet). Në varësi të lëndës mund të llogaritet edhe numri i vlerësimeve. Kolona e komenteve në faqe A3 duhet të jetë më e gjatë.